



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	4595125
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	01.09.25
VUSHTRRI - VUÇITRN	

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



02Nr. PB 865/25
Datë, 01.09.2025

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), si dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PER THEMELIM TË KOMISIONIT

1. Themelohet komisioni për identifikimin e shtabit, vendqëndrimeve, istikameve dhe spitaleve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në mbarim të luftës në qershor 1999.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
 - 2.1 **Bajram Beqiri**, - kryesues i komisionit,
 - 2.2 **Musaj Tërbunja**, - anëtar,
 - 2.3 **Gëzim Saraçi**, - anëtar,
 - 2.4 **Xhavit Haziri**, - anëtar
 - 2.5 **Shaip Hyseni**, - anëtar
3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë identifikimin e v shtabit, vendqëndrimeve, istikameve dhe spitaleve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në territorin e Komunës së Vushtrrisë deri në mbarim të luftës në qershor 1999, në të cilat do të vendosen pllaka përkujtimore në shenjë respekti dhe nderimi të ushtarëve të UÇK-së. Me rastin e përcaktimit për vendosje të pllakave përkujtimore duhet të merret parasysh edhe xhamia e fshatit Reznik në të cilën në oborrin e kësaj xhamie janë vendosur qindra mijëra refugjatë për të shpëtuar nga sulmet barbare të forcave ushtarake policore e paramilitare serbe.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Antarëve të komisionit
- QSHQ
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRIN

02 Nr. / Nr. 48820/25
Nr. i fq. / Br. sh. 1-
Data: / Datum 12.09.25

VUSHTRRI - VUČITRIN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



02Nr. PB 903/25

Datë, 12.09.2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR THEMELIM TË KOMISIONIT

1. Themelohet komisioni për verifikimin e bizneseve në sheshin "Adem Jashari" në Vushtrri të cilat janë të prekura nga ndikimet e punëve me rastin e implementimit të projektit "Ndërtimi i Parkingut Nëntokësor" si dhe projekti i asfaltimit të rrugës "Drenica" në Vushtrri.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
 - 2.1 Qemajl Hasani, Kryesues i komisionit - Drejtoria për Buxhet dhe Financa
 - 2.2 Fatlum Hyseni, anëtar – Drejtoria për Urbanizëm
 - 2.3 Floriana Leku Sadiku, anëtare - Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Qëllimi i verifikimit të fakteve sipas pikës 1 të këtij vendimi është që të shqyrtohen mundësitë për lirimin nga pagesa e obligimeve financiare ndaj komunës të bizneseve që kanë pasë pengesa në punë gjatë realizimit në terren të projektit "Ndërtimi i Parkingut Nëntokësor" dhe projekti asfaltimi i rrugës "Drenica". Në rast nevojë komisioni ka mandat edhe për ndonjë rast tjetër eventual ku ndonjë biznes i komunës ka pasë pengesa në punë për një periudhë më të gjatë kohore me rastin e implementimit të projektit nga komuna.
4. Komisioni, për punët që do të kryej sipas këtij vendimi do të paraqes raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.
5. Komisioni do të filloj me punë menjëherë.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- QSHQ
- Arkiv